



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Nr. i Dokumentit: 22.20.1-2017-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË
NOVOBËRDËS
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2017

Prishtinë, maj 2018

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikatat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Novobërdës, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Valbon Bytyqi, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Udhëheqësi i ekipit të auditimit Faik Thaçi, si dhe Anëtarët Milosh Petroviq dhe Ejup Simnica, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Mujë Gashi.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	11
4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	19
5 Qeverisja e mirë.....	20
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA	23
Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dy viteve paraprake.....	26
Shtojca III: Letër konfirmimi	32

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky Raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të Komunës së Novobërdës për vitin 2017, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2017 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 09.10.2017.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Puna e ndërmarrë nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2017 është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i komunës.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson Menaxhmentin e lartë dhe stafin e komunës për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i Pamodifikuar me theksim të çështjes


Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2017 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se gjendja e pasurive jo financiare e evidentuar në regjistrat e pasurisë si dhe e shpalosur në pasqyra financiare vjetore nuk ishte plotësisht e saktë. Në këtë regjistrë nuk ishin evidentuar tokat në pronësi komunale, 22 automjete komunale si dhe investimet kapitale të bëra në vitin 2017 në vlerë 364,888€.

Më gjërsisht shih Pjesën 2.1 të këtij Raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e ndryshme të opinionëve të aplikuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore**Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2017**

Kryetari është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresoj të gjitha rekomandimet e dhëna.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Hyrje

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, si dhe dhënien e opinionit:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut për auditimin e komunës. Ne kemi analizuar veprimtarinë e komunës se deri në çfarë mase mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë që mbështesin opinionin e Auditorit të Përgjithshëm (AP).

Seksionet e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve tona të auditimit, me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontroleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Auditimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Gjithashtu merret parasysh edhe deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave (MF).

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

2.1 Opinioni i auditimit

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Ne kemi audituar PFV-të e Komunës së Novobërdës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, shpalosjet dhe raportet tjera përcjellëse.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësim dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj, për faktin se pasuritë jo financiare nuk janë prezantuar saktë në PFV. Në regjistrin e pasurive nuk ishin evidentuar tokat në pronësi komunale, 22 automjete komunale si dhe investimet kapitale të bëra në vitin 2017, në vlerë prej 364,888€. Si rrjedhojë gjendja e pasurive në regjistrat e pasurive dhe shpalosja e tyre në PVF-të e vitit 2017 ishin nënvlerësuar.

Mangësitë e tilla përpos, nënvlerësimit të tyre në PFV, mund të shkaktojnë ekspozimin e pasurive pranë rrezikut të humbjes apo keq menaxhimit.

Opinionin jonë nuk është modifikuar (apo kualifikuar) për këtë çështje.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisje për PFV

Kryetari i Komunës së Novobërdës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar, si dhe është përgjegjës për kontrole të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të komunës.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Komuna kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFPP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 01/2013 dhe 02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve;
- Nëse PFV janë përgatitur brenda kornizës kohore dhe janë dorëzuar në MF;
- Nëse Draft plani dhe plani përfundimtar i prokurimit është dorëzuar me kohë; dhe
- Nëse Komuna kishte përgatitur dhe dorëzuar raporte të rregullta tremujore tek Kuvendi Komunal dhe një kopje tek MF.

PFV-të e dorëzuara në muajin janar 2018 ishin prezantuar me gabime, si në vijim:

- Neni 16, Raporti për të arkëtueshmet, përmbante vetëm të dhënat mbi tatimin në pronë për vitin 2017, por jo edhe të arkëtueshmet e viteve të më hershme;
- Neni 19.3.1, Raporti për pasurinë kapitale me vlerë mbi 1,000€, nuk është paraqitur vlera e pasurive, si dhe mungonte toka si kategori e pasurive;
- Neni 19.3.2, Pasuritë nën 1,000€, nuk janë paraqitur vlerat e kësaj pasurie as për vitin aktual e as për vitet paraprake;
- Neni 21, Raporti për të hyrat vetjake të pa shpenzuara, ishte mbivlerësuar për 141,316€; dhe
- Neni 27, Në raportin e të punësuarve me marrëveshje për shërbime të veçanta, nuk ishte prezantuar asnjë i angazhuar, derisa gjatë vitit 2017 ekzistonin gjashtë marrëveshje të tilla.

Me pas komuna ka korrigjuar pasqyrat e saj duke përmirësuar raportimin e saj, duke korrigjuar gabimet e lartcekura.

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të draft PFV-ve në Ministrinë e Financave, mund të konsiderohet e saktë. Çështjet lidhur me evidencat jo të plota të pasurisë i kemi shpalosur te theksimi i çështjes.

Në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, nuk kemi çështje për të ngritur.

2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Për çështjet e sipër përmendura jepet rekomandimi:

Rekomandimi 1 Kryetari duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Theksim të Çështjes së opinionit të auditimit, si dhe të marrë veprime specifike për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike dhe për ta konfirmuar regjistrimin e plotë të pasurisë kapitale. E gjitha pasuria, përfshirë pronat të cilat i posedojnë si dhe pasuritë jo financiare të blera/ndërtuara duhet të regjistrohen në regjistrat e pasurisë.

Gjithashtu, Kryetari duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2018 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo, gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë ose fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të nënshkruhet përveç nëse ndaj PFV-të janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, në fokus të auditimit ishte menaxhimi i buxhetit, çështjet e prokurimit, burimet njerëzore, llogaritë e arkëtueshme, pasuritë si dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Komuna e Novobërdës kishte shpenzuar 97% të buxhetit final për vitin 2017, që nënkupton një realizim të mirë në nivel të përgjithshëm, megjithëse kishte ngecje në realizimin e projekteve kapitale. Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi të hyrat janë në përgjithësi të përshtatshme dhe duke u zbatuar në mënyrë efektive, megjithatë nevojiten mekanizma shtesë për të reaguar në inkasimin e tyre dhe mbledhjen e të arkëtueshmeve në masë më të madhe.

Fushat kryesore ku nevojiten përmirësime të mëtejme janë menaxhimi i shpenzimeve, si dhe menaxhimi dhe raportimi i pasurisë dhe obligimeve.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore, shpenzimet e fondeve si dhe të hyrat e arkëtuara sipas kategorive ekonomike, duke i paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ¹	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Burimet e Fondeve:	2,331,854	2,408,818	2,342,124	2,098,485	2,095,487
Granti i Qeverisë -Buxheti	2,113,025	2,115,608	2,114,032	1,810,180	1,822,548
Të bartura nga viti paraprak ² -	-	40,684	40,564	61,903	73,137
Të hyrat vetjake ³	218,829	218,829	159,618	203,847	137,588
Donacionet e brendshme	-	21,040	15,266	3,928	14,436
Donacionet e jashtme	-	12,657	12,644	18,627	47,778

¹ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave.

² Të hyrat vetjake të Komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

³ Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e aktiviteteve vetjake.

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 76,964€. Kjo rritje është rezultat i donacioneve vendore dhe të jashtme në vlerë 33,697€, të hyrave të bartura nga viti paraprak në vlerë 40,684€ dhe grantit qeveritar në vlerë 2,583€.

Në vitin 2017, komuna ka shpenzuar 97% të buxhetit final ose 2,342,125€, me një trend të njëjtë me dy vitet paraprake.

Ne raport me buxhetin fillestar, buxheti final për shpenzime kapitale kishte pësuar rritje për vlerën 48,824€. Megjithatë shpenzimet e realizuara për investime kapitale në raport me buxhetin final ishin 87%. Më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	2,331,854	2,408,818	2,342,125	2,098,485	2,095,487
Pagat dhe Mëditjet	1,754,425	1,767,008	1,767,008	1,740,370	1,707,915
Mallrat dhe Shërbimet	151,088	163,419	152,556	161,882	130,156
Shërbimet komunale	46,000	47,533	47,001	55,456	41,072
Subvencionet dhe Transferet	9,521	11,213	10,670	11,355	5,270
Investimet Kapitale	370,820	419,644	364,888	129,422	211,074

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Paga dhe mëditje – buxheti final është rritur për 12,583€ nga të hyrat e bartura prej vitit paraprak;
- Mallra dhe shërbime – buxheti final është rritur për 12,331€ (1,282€ nga të hyrat e bartura prej vitit paraprak dhe 11,049€ nga të hyrat vetjake);
- Subvencionet dhe transferet – buxheti final është rritur 1,692€ nga të hyrat e bartura prej vitit paraprak; dhe
- Investimet Kapitale – rritja e buxhetit final për investime kapitale në vlerë 48,824€, ishte si rezultat i të hyrave të bartura nga viti paraprak në vlerë 25,127€, si dhe granteve nga donatorët e brendshëm dhe të jashtëm në vlerë 23,697€.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.2 Të hyrat

Komuna ka një trend të njëjtë si në inkasimin e të hyrave vetjake ashtu edhe në planifikimin e tyre, krahasuar me vitet paraprake. Me buxhet fillestar ishin planifikuar 218,829€, derisa ishin realizuar 192,030€, ose 88% e buxhetit. Të hyrat vetjake kryesisht përbëhen nga tatimi në pronë, lejet e ndërtimit, ndarja e pronave si dhe taksat tjera komunale.

Në strukturën buxhetore, të hyrat vetjake marrin pjesë me rreth 9% në totalin e buxhetit.

Tabela 3. Të hyrat vetjake (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2017 Pranimet	2016 Pranimet	2015 Pranimet
Të hyrat vetjake	218,829	218,829	192,030	237,259	187,188
Totali	218,829	218,829	192,030	237,259	187,188

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.3 Pagat dhe shtesat

Në kategorinë e pagave dhe mëditjeve, në buxhetin final, komuna kishte planifikuar shpenzimet në vlerë 1,767,008€. €, ose mbi 73% të totalit të shpenzimeve. Kjo kategori është shpenzuar 100% gjatë vitit 2017.

Pagat dhe mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar që menaxhohet nga MF. Kontrollat që operojnë në nivel lokal nga komuna kanë të bëjnë me: kontrollin e pagesave, duke i nënshkruar listat e pagave; verifikimin e ndryshimeve të mundshme që mund të paraqiten përmes formularëve; dhe rishikimin e buxhetit për këtë kategori dhe barazimet me thesarin.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.4 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Mallrat dhe shërbimet si dhe komunalit, me buxhetin fillestar ishin planifikuar në vlerë 197,088€, mirëpo me rishikim të buxhetit vlera e tyre ishte rritur në 210,952€. Gjatë vitit 2017 janë shpenzuar 199,567€ apo 95%. Mallrat dhe shërbimet në buxhetin e komunës marrin pjesë me 9% të totalit të shpenzimeve.

Janë disa aspekte të procesit të shpenzimit të parasë publike për mallra dhe shërbime mbi të cilat kontrollet duhet të shtohen.

Çështja 2 - Angazhimet sipas marrëveshjeve për shërbime të veçanta

E gjetura Gjatë vitit 2017, komuna kishte angazhuar gjashtë të punësuar me marrëveshje për shërbime të veçanta. Ndonëse sipas ligjit për shërbimin civil, neni 12, për emërimet të tilla, zbatohet një procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit, komuna nuk kishte respektuar ato me rastin e përzgjedhjes.

Me tutje, identifikua se pagesat e bazuara në këto marrëveshje ishin bërë të plota, duke mos ndalur tatimin në burim dhe kontributin pensional ashtu siç përcaktohet me Ligjin nr. 05/L-028 për tatime në të ardhura personale⁴.

Rreziku Anashkalimi i procedurave të rekrutimit me rastin e lidhjes së kontratave për shërbime të veçanta, rrit rrezikun të rezultojë me angazhimin e personave jo të duhur për kryerjen e shërbimeve të kërkuara, si dhe nuk siguron trajtim të barabartë për të gjithë konkurrentët potencial. Ndërsa, mos mbajtja e tatimit dhe i kontributeve pensionale ndikon në mbledhjen e të hyrave të përgjithshme buxhetore si dhe paraqet rrezik për pagesën eventuale së gjobave.

Rekomandimi 2 Kryetari duhet të siguroj se marrëveshjet për shërbime të veçanta lidhen pas zhvillimit të procedurave të thjeshtësuara të rekrutimit, si dhe të shtoj kontrollin me rastin e pagesave të tilla duke respektuar procedurat për ndaljen e tatimit në burim si dhe kontributeve pensionale.

3.5 Subvencionet dhe transferet

Subvencionet janë kategori e ndihmave financiare pa kthim të drejtpërdrejtë që u jepen përfituesve nga komuna. Ato kryesisht u ndahen entiteteve publike dhe jo publike dhe personave fizik në nevojë. Kontrollat e zbatuara nga komuna përcaktohen me rregulloren e brendshme dhe udhëzimet e përgjithshme të shpenzimit të parasë publike. Buxheti final për kategorinë e subvencioneve dhe transfereve për vitin 2017 ishte 11,213€. Prej tyre ishin shpenzuar 10,870€, apo 97% e buxhetit.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

⁴ Ligji nr. 05/L-028 për tatime në të ardhura personale, (në fuqi nga data 01.09.2015) në nenin nr. 38, citon “Secili punëdhënës është përgjegjës të mbajë në burim tatimin nga pagat e tatueshme të paguara punëtorëve të tij, duke përfshirë edhe pagesat për shërbimet profesionale, teknike, të menaxhimit, financiare, pagesat për kontratat mbi vepër, pagesat për shfaqje të aktorëve, muzikantëve, sportistëve, agjentëve të varur etj, gjatë çdo periudhe të listë pagesës për të cilën të ardhurat e tyre janë paguar”.

3.6 Investimet kapitale

Me buxhetin fillestar komuna kishte ndarë 370,820€ për investime kapitale, mirëpo me rishikim të buxhetit kjo vlerë ishte rritur për 48,824€ duke e rritur buxhetin final në 419,644€. Nga kjo shumë komuna kishte shpenzuar 364,888€ apo 87%.

Në strukturën e buxhetit fillestar shpenzimet kapitale marrin pjesë me 16%.

Çështja 3 – Mos zbatimi i procedurave të prokurimit dhe marrëveshjeve për bashkëfinancim

E gjetura Si pasojë e mungesës së mbikëqyrjes efektive menaxheriale nuk është zbatuar mjaftueshëm legjislacioni i prokurimit publik si dhe nuk janë zbatuar marrëveshjet e bashkëfinancimit, si në vijim:

- Në dy raste komuna kishte lidhur kontrata pa zbatuar procedurat e prokurimit, si: “Kontrata për pastrimin e borës”, në vlerë 7,600€ si dhe “Kontrata për largimin e mbeturinave”, në vlerë 5,292€. Lidhjet e kontratave ishin bazuar në vendimet e kryetarit;
- Komuna ka nënshkruar marrëveshje bashkëfinancimi me një donator për projektin “Zhvillimi i Mikro Bizneseve”, në vlerë 91,025€. Sipas nenit nr.4 të marrëveshjes, parashihet që komuna paraprakisht të formoj një komision për pranimin dhe realizimin e projektit. Megjithatë komuna pa respektuar kërkesat e lartpërmendura kishte paguar 12,000€; dhe
- Komuna kishte nënshkruar marrëveshje bashkëfinancimi me një donator për mbjelljen e fidanëve të mjedrës. Sipas marrëveshjes, donatori duhet të sjellë listën e përfituesve dhe dëshmitë tjera, e më pas komuna do të participojë me 3,180€ apo 30% të vlerës së kontratës. Ne vërejtëm se komuna kishte bërë pagesën duke u bazuar vetëm në faturë, në mungesë dëshmive mbi listën e përfituesve.

Rreziku Nënshkrimi i kontratave pa procedura të prokurimit rrezikon trajtimin e operatorëve ekonomik në mënyrë të barabartë, diskriminuese dhe jo-transparente (neni 7.1 i LPP). Gjithashtu mos zbatimi i duhur i marrëveshjeve për bashkëfinancim rrit rrezikun e mos realizimit të projekteve sipas marrëveshjeve të nënshkruara.

Rekomandimi 3 Kryetari i Komunës duhet të forcoj mbikëqyrjen efektive menaxheriale për të siguruar se janë ndërprerë plotësisht praktikatat e lidhjes së kontratave pa procedura si dhe të siguroj se gjatë vitit 2018 të gjitha shpenzimet për investime kapitale realizohen në përputhje të plotë me kërkesat ligjore të prokurimit. Me tutje, të sigurojë se janë duke u respektuar të gjitha kërkesat e dala nga marrëveshjet e arritura për bashkëfinancim.

Çështja 4 – Mungesë e evidencave lidhur me përdorimin e automjeteve

- E gjetura** Komuna ka në pronësi 22 automjete zyrtare të cilat i përdor për aktivitetet operative komunale. Lidhur me përdorimin dhe mirëmbajtjen e automjeteve zyrtare, komuna ka nxjerrë dhe aprovuar rregulloren e brendshme, megjithatë ajo nuk respektohet gjatë përdorimit të automjeteve.
- Nga testimet e urdhëresave të udhëtimit për tri automjete, vërejtëm se nuk plotësohen urdhëresat e udhëtimit, nuk evidentohen kilometrat e kaluara si dhe në disa raste automjetet zyrtare përdoren pa aprovim paraprak.
- Rreziku** Mos zbatimi i rregullores së brendshme të aprovuar nga komuna rritë rrezikun e keqpërdorimit dhe përdorimit të pa autorizuar të tyre, përfshirë edhe rritjen e shpenzimeve për karburante, për servisimin dhe mirëmbajtjen e tyre.
- Rekomandimi 4** Kryetari i Komunës duhet të forcoj kontrollet në menaxhimin dhe raportimin e shfrytëzimit të automjeteve në përputhje të plotë me kërkesat e përcaktuara me rregullore. Për shfrytëzimin e automjeteve paraprakisht duhet të bëhet aprovimi, e më pas duhet të mbahen evidenca të plota për shfrytëzimin e tyre, përfshirë edhe mirëmbajtjen e tyre.

3.7 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Komuna nuk ka arritur ta përfundojë regjistrimin e pasurive në SIMFK, ndërsa pasurinë nën 1,000€ nuk i ka të regjistruara fare në asnjë sistem. Kryetari i Komunës me kohë kishte formuar një komision për inventarizimin e pasurive të cilët e kishin përfunduar punën, por nuk kishte arritur të krijoj një raport për gjendjen e pasurive. Vlera neto e pasurive në SIMFK, pas llogaritjes së zhvlerësimit të akumuluar, për vitin 2017 ishte 1,031,340€, derisa në vitin 2016 vlera neto e pasurive ishte 1,180,297€, që pasqyron një ngecje në regjistrimin e pasurive. Mangësitë në regjistrin e pasurisë janë trajtuar në pjesën 2.1 Baza për opinion - Theksimi i Çështjes. Përveç kësaj, janë hasur edhe mangësi tjera të prezantuara në vijim:

Çështja 5 - Mungese e evidencave mbi pasurinë

E gjetura Sipas rregullores mbi pasurinë jo financiare⁵, pasuria nën 1,000€ dhe stoqet duhet të regjistrohen në sistemin E-pasuria. Komuna nuk ka respektuar këtë kërkesë ligjore dhe nuk mban kurrfarë evidencash lidhur me pasurinë më vlerë nën 1,000€, përfshirë dhe stoqet. Kjo gjendje ishte konstatuar edhe në raportin e vitit paraprak dhe ne kemi rekomanduar për të përmirësuar kontrollet në menaxhimin e pasurisë, mirëpo menaxhmenti i komunës përkundër zotimit për zbatimin e tij nuk ka marrë kurrfarë masash në këtë drejtim. Si pasojë komuna nuk ka informata lidhur me vlerën e pasurisë të cilën posedon.

Komisioni për inventarizimin e pasurisë komunale, ishte formuar me vendim të kryetarit dhe kishte kryer inventarizimin e pasurisë, mirëpo raporti i dorëzuar ishte shumë i mangët, përkatësisht nuk përmban informata të mjaftueshme lidhur me gjendjen e pasurive.

Rreziku Dobësitë e identifikuar në regjistrimin e pasurive jo kapitale, shpijnë në rrezikun për menaxhimin joefikas të këtyre pasurive si dhe nënvlerësimin e tyre në shpalosjen e pasqyrave financiare. Ndërsa inventarizimi jo i plotë i pasurisë, shkakton mangësi në menaxhimin dhe raportimin e saktë të tyre, duke rrezikuar njëkohësisht keqpërdorimin apo humbjen e pasurive.

Rekomandimi 5 Kryetari duhet të marrë të gjitha veprimet e nevojshme, për të siguruar funksionalizimin e sistemit e-pasuria dhe evidentimin e të gjitha pasurive më vlerë nën 1,000€ dhe stoqeve në këtë sistem. Me pas në fund të vitit para përgatitjes së pasqyrave financiare të kryhet procesi i inventarizimit i cili mundëson krahasimin e me regjistrin e përgjithshëm të pasurive, dhe diferencat e mundshme të pasqyrohen në regjistrat e pasurive.

3.8 Të arkëtueshmet

Komuna e Novobërdës në PVF -2017 ka deklaruar llogari të arkëtueshme vlerën 307,959€. Te gjitha të arkëtueshmet rrjedhin nga tatimi në pronë. Krahasuar me vitin e kaluar këto llogari kishin pësuar rritje në vlerë 66,510€ apo për 22%.

Çështja 6 – Rritja e llogarive të arkëtueshme

E gjetura Komuna për vitin 2017 kishte planifikuar të hyrat nga tatimi në pronë në vlerë 69,689€, ose 25% me të ulëta në raport me vlerën e faturimit (faturimi ishte 93,263€). Megjithatë edhe përkundër planifikimit të ulët në këtë kategori, niveli i realizimit ishte edhe me i ulët në 62,206€.

⁵ Rregullore nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, neni 6.

Mungesa e politikave adekuate dhe masave konkrete për mbledhjen e të hyrave ka rezultuar me nivele të larta dhe rritje të vazhdueshme të llogarive të arkëtueshme.

- Rreziku** Niveli i lartë i të arkëtueshmeve dhe jo efikasiteti në mbledhjen e tyre mbeten sfidë edhe për periudhën e ardhshme. Mos inkasimi i të arkëtueshmeve rrezikon që ato vjetërsohen dhe të bëhen të pambledhshme duke krijuar një humbje të drejtpërdrejtë financiare për Komunën.
- Rekomandimi 6** Kryetari, duhet të siguroj që po shqyrtohen në mënyrë aktive të gjitha opsionet e mundshme, duke vendosur politika dhe rregullore me qëllim të rritjes së efikasitetit në mbledhjen e të arkëtueshmeve. Po ashtu duhet shqyrtuar të gjitha masat në pajtim me ligjin, për të siguruar inkasimin me kohë të llogarive të arkëtueshme.

3.9 Obligimet e papaguara

Pasqyra e obligimeve të papaguara ndaj kreditorëve në fund të vitit 2017 ishte 68,152€, pothuajse me vlerë të njëjtë me obligimet e raportuara në vitin e kaluar. Këto obligime janë bartur për t'u paguar në vitin 2018. Obligimet e pa paguara përfshijnë furnizimet për zyre, derivateve, servisim i veturave, pajisje të teknologjisë informative etj.

Ne kemi ekzaminuar pagesat në tremujorin e parë të vitit 2018 ku kanë rezultuar me pagesat e obligimeve të vitit të kaluar, që konfirmojnë plotësinë e obligimeve.

Çështja 7 – Mos raportimi i obligimeve në thesar

- E gjetura** Komuna gjatë vitit 2017, nuk ka arritur t'i menaxhoj dhe raportoj obligimet ndaj furnitorëve në përputhje me kërkesat e Rregullores së thesarit 02/2013, për raportimin e obligimeve të papaguara të organizatave buxhetore. Ata nuk mbajnë libër të protokollit për evidentimin e faturave të papaguara dhe nuk raportojnë në baza mujore lidhur me obligimet e tyre.
- Rreziku** Mos raportimi i rregullt mujor i obligimeve, ose mos zbatimi i rregullave financiare, mund të rezultojë me pagesa të paplanifikuara nga buxheti i vitit të ardhshëm. Mos mbajtja e një libri të protokollit për faturat e pranuar, mund të rezultojë me vonesa të pagesave të faturave apo edhe me pagesa të dyfishta.
- Rekomandimi 7** Kryetari, duhet të forcoj kontrollet lidhur me menaxhimin dhe raportimin e obligimeve të papaguara. Fillimisht, duhet të siguroj mbajtjen e një libri të protokollit, ku do të regjistrohen dhe protokollohen të gjitha faturat e pranuar. Me tutje të krijojë një sistem efektiv në të cilin të gjitha faturat e papaguara raportohen në mënyrë të saktë dhe të plotë në baza mujore në MF, si dhe në fund të çdo viti shpalosen saktë në PFV.

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e vitit 2016 të Komunës së Novobërdës ka rezultuar në 14 rekomandime kryesore. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do të zbatohen rekomandimet e dhëna. Përkundër rekomandimit tonë që raporti i vitit 2016 të diskutohet në Asamblenë Komunale, ky raport nuk ishte diskutuar.

Deri në fund të auditimit për vitin 2017, pesë rekomandime ishin zbatuar, pesë ishin në proces të zbatimit dhe katër nuk janë adresuar.

Po ashtu, nga viti 2015 ishin bartur gjashtë rekomandime për tu zbatuar gjatë vitit 2017, nga të cilat katër kanë mbete të pa zbatuara, ndërsa dy ishin në proces të zbatimit. Për një përkrahje më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shih Shtojcën II.

Çështja 8 - Zbatimi i rekomandimeve nga viti paraprak dhe viti i mëhershëm

E gjetura Për shkak të menaxhimit jo të mirë të procesit dhe mungesës së një monitorimi formal për mënyrën e zbatimit të rekomandimeve të AP-së, një pjesë e konsiderueshme e rekomandimeve kanë mbetur të pazbatuara, ose në proces të zbatimit, përfshirë këtu edhe rekomandimet nga vitet e mëhershme. Kjo tregon një mungesë të përqendrimit të personave përgjegjës në aplikimin e masave konkrete lidhur me zbatimin e tyre, që vijnë si rezultat i dobësive të identifikuara në komunë.

Zbatimi i rekomandimeve të dhëna në vitet paraprake do të ndikonte në eliminimin e dobësive në kontrollet e menaxhmentit, si:

- Në menaxhimin, evidentimin dhe raportimin e pasurisë;
- Zbatimin e kërkesave të pajtueshmërisë me legjislacionin; si dhe
- Në zbatimin e kërkesave për një qeverisje të mirë.

Rreziku Mos zbatimi i rekomandimeve të dhëna në vitin e kaluar dhe viteve të mëhershme, shpie deri të rreziku i pasqyrimin jo të drejtë në raportet financiare si dhe mundësinë e përsëritjes së gabimeve.

Rekomandimi 8 Kryetari duhet të siguroj që zbatimi i planit të veprimit, monitorohet në vazhdimësi dhe raportohet në baza të rregullta mujore ose tre mujore në lidhje me progresin e arritur në këtë drejtim. Rekomandimet të cilat nuk zbatohen sipas afateve, të rishikohen në një afat të shkurtër nga kryetari, si dhe të ndërmerren veprime pro-aktive ndaj barrierave të paraqitura gjatë zbatimit.

5 Qeverisja e mirë

Hyrje

Për komunën, aranzhimet efektive të qeverisjes janë thelbësore që të menaxhojë në mënyrë të suksesshme sfidat me të cilat përballet dhe të sigurojë ofrimin e shërbimeve më të mira në dobi të taksapaguesve dhe të shfrytëzuesve tjerë të shërbimeve.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmerr veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK-së nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i pyetësorëve të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat në fund të vitit i dorëzohen MF-së.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentët tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Komuna kishte arritur të përmbushë kërkesën e MF-së për dorëzimin e pyetësorit të vetvlerësimit, megjithatë në aspektin e menaxhimit të rrezikut, komuna ende nuk ka arritur të përgatisë listën e rreziqeve përmes së cilës do të identifikoheshin pika të rëndësishme të rreziqeve me të cilat përballen departamentet përkatëse dhe reagimet e rreziqeve të identifikuara.

Një ndër elementet kyçe të një qeverisje efektive është edhe zbatimi i rekomandimeve të dhëna nga auditimi i jashtëm. Përgjigja efektive ndaj zbatimit të rekomandimeve nuk është e kënaqshme. Kjo pjesë është trajtuar më detajisht tek kapitulli 'Progresi i zbatimit të rekomandimeve'.

Komuna nuk kishte raportime të rregullta në asamblenë komunale, si rezultat i mos dorëzimit të raporteve tremujore dhe nëntëmujore. Sa i përket raportimit të brendshëm, nuk ka raportime të rregullta javore dhe mujore.

Për me tepër, komuna ka hartuar planin strategjik në nivel të organizatës, mirëpo ende nuk ka hartuar planet urbanistike, hapësinore, plani operativ emergjent etj.

5.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Ndikimi i produkteve të auditimit të brendshëm duhet të gjykohet nga rëndësia që i jep menaxhmenti adresimit të rekomandimeve të dhëna.

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) në komunë operon me një auditor, i cili njëkohësisht është drejtor i njësisë. NJAB kishte përgatitë planin strategjik tre vjeçar si dhe planin vjetor të auditimit

për vitin 2017, i cili është aprovuar nga menaxhmenti i Komunës. NJAB, për vitin 2017 kishte planifikuar dhe realizuar shtatë auditime.

Çështja 9 – Funkcionimi i NJAB-së dhe mos themelimi i komitetit të auditimit

E gjetura Ekzistojnë një numër dobësish në lidhje me sistemin aktual të auditimit të brendshëm, si:

- Menaxhmenti nuk kishte hartuar plane të veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga NJAB; dhe
- Komiteti i Auditimit ende nuk është themeluar.

Këto rezultate pasqyrojnë mungesën e vëmendjes së menaxhmentit për njohjen dhe maksimizimin e përfitimit nga auditimi i brendshëm, respektivisht në marrjen e sigurisë për funksionimin efektiv të kontrolleve të brendshme.

Rreziku Mos përcjellja e adresimit të rekomandimeve zhvlerëson rezultatet e punës së NJAB-ve dhe nuk sjellë përmirësimin e sistemeve. Në mungesë të themelimit të komitetit të auditimit dobësohet roli dhe pavarësia e auditimit të brendshëm.

Rekomandimi 9 Kryetari duhet të forcoj rolin e NJAB-së si element kyç i sistemit të kontrollit të brendshëm për të nxjerrë auditime cilësore, të sigurojë se përgatiten planet e veprimit për secilin raport të auditimit si dhe në mënyrë sistematike të monitorojë progresin kundrejt planit për të siguruar zbatimin e rekomandimeve brenda afateve të përcaktuara. Me tutje duhet të sigurojë themelimin e komitetit të auditimit si dhe funksionimin e rregullt të tij, për të siguruar pavarësinë e NJAB-së.

5.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Për të pasur një planifikim të mirë, për të mbikëqyrë aktivitetet në baza të rregullta dhe për të mundësuar vendimmarrje efektive, menaxhmenti ka nevojë të posedoj raporte të rregullta. Llogaridhënia si proces është pranimit i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë organizatën.

Menaxhmenti, ndonëse ka zbatuar një numër kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet funksionojnë si duhet, ne kemi vërejtur se masat e aplikuara nuk janë mjaft efektive dhe nuk mundësojnë një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

Çështja 10 - Dobësi në kontrollet menaxheriale

E gjetura Rishikimi ynë i kontrolleve menaxheriale të zbatuara në sistemin kryesor financiar të komunës ka nxjerrë në pah një raportim financiar jo të duhur. Forma aktuale e raportimit nuk ofron siguri dhe saktësi informatash në fusha të ndryshme të shtjelluara brenda këtij raporti. Më tutje, kontraktimi pa procedura të prokurimit, dhe mos respektimi i kriterëve në marrëveshjet e bashkëfinancimeve janë disa nga çështjet të cilat duhet të përmirësohet nga menaxhmenti. Poashtu regjistrat e pasurisë ende nuk ishin të saktë si rezultat i mungesës së regjistrimeve.

Komuna ka hartuar planin strategjik, mirëpo ende nuk ka hartuar planet, si: planet urbanistike, hapësinore, plani operativ emergjent etj. Me tutje komuna nuk posedon regjistër të rreziqeve të hartuar sipas kërkesave të MFK-së, për t'i identifikuar rreziqet në nivel të departamenteve dhe marrjen e masave për menaxhimin e tyre.

Rreziku Kërkesat e llogaridhënies dhe raportimi financiar duhet të forcohen për të përkrahur efektivitetin e menaxhimit financiar brenda komunës. Raportet financiare duhet të rishikohen dhe verifikohen në mënyrë që informacioni financiar të jetë i krahasueshëm dhe i plotë në funksion të konsistencës dhe mbi të gjitha ta përkrahë vendimmarrjen.

Rekomandimi 10 Kryetari, duhet të siguroj se ka hartuar të gjitha planet operative si dhe është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë. Gjithashtu, për të reduktuar ndikimin e rreziqeve në nivele të pranueshme, komuna duhet të hartoj regjistrin e rreziqeve me të gjitha masat/veprimet e duhura për të vendosur nën kontroll kërcënimet e ekspozuara.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet të japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dy viteve paraprake

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e bartura nga viti 2015	Të zbatuara gjatë vitit 2017	Në proces të zbatimit gjatë 2017	Të pa zbatuara
2.3 Zbatimi i rekomandimeve nga viti paraparak	Kryetari duhet të sigurojë që është zbatuar plani i veprimit, i rishikuar, i cili i përcakton saktë afatet kohore për implementime të rekomandimeve të bëra nga AP, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme. Procesi i zbatimit të këtij plani duhet të monitorohet në baza të rregullta nga Kryetari i Komunës.		Komuna e kanë përgatit planin për zbatimin e rekomandimeve, mirëpo niveli i zbatimit të rekomandimeve është shumë i ulët.	
2.5.2 Raportimi menaxherial	Kryetari duhet të sigurojë se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë dhe të sigurojë se është vendosur një zgjidhje e përshtatshme deri në tetor 2016.		Komuna ka filluar ta përmirësoj formën e raportimit, megjithëse ende nuk ka raportime të rregullta javore dhe mujore.	
2.6 Sistemi i auditimit të brendshëm	Kryetari duhet të sigurojë themelimin e Komitetit i Auditimit për të arritur përfitimin maksimal nga aktiviteti i auditimit të brendshëm. Komiteti i Auditimit duhet të rishikojë në mënyrë kritike burimet, planet dhe rezultatet e auditimit të brendshëm për të konfirmuar se ato bazohen në rrezik dhe t'i ofrojë sigurinë e kërkuar menaxhmentit. Gjithashtu, duhet të rishikojë veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti në lidhje me rekomandimet e auditimit të brendshëm.			Nuk janë marrë masa.

3.4 Prokurimi	Kryetari duhet t'i rishikojë kontrollet dhe të merr masa të menjëhershme që të hartoj një rregullore të brendshme për përdorimin e automjeteve zyrtare të komunës, në mënyrë që përdorimi i automjeteve të bëhet në mënyrë të autorizuar vetëm për nevoja zyrtare. Raportet për shpenzimet e përgjithshme dhe individuale për secilin automjet duhet të hartohen nga një zyrtar i ngarkuar me njësinë e transportit dhe të njëjtat të rishikohen nga menaxhmenti për të siguruar përdorimin racional dhe në pajtim me kërkesat e rregullores.			Nuk janë marrë masa.
3.7.1 Pasuritë kapitale dhe jo kapitale	Kryetari duhet të sigurojë një proces efektiv të regjistrimit të të gjitha pasurive, duke përcaktuar rolet kyçe, që në këtë proces mund të ketë Drejtorja e Kadastrit, duke mbledhur dhe raportuar të gjitha të dhënat mbi pronat në posedim të komunës. Më pas, një komision i veçantë duhet të bëjë një vlerësim të pasurive të identifikuara dhe, pas rishikimit kritik nga ana e Kryetarit, një raport t'i dorëzohet zyrtarit të pasurive për t'i proceduar regjistrimet e duhura në sistemin e SIMFK-së (moduli i pasurive). Gjithashtu, komisionet për inventarizim dhe vlerësim të pasurive duhet të krijohen çdo vit në kohë adekuate që të kryhet inventarizimi i tërësishëm për të konfirmuar ekzistencën e pasurive (në veçanti të pasurive të luajtshme). Të gjitha aktivitetet duhet të monitorohen nga ana e Kryetarit dhe të kryhen para se PVF-të e vitit 2016 të jenë dorëzuar në MF.			Nuk janë marrë masa.

3.7.2 Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari i duhet t'i analizojë arsyet e nivelit të lartë të arkëtueshmeve dhe t'i forcojë kontrollet për të parandaluar rritjen e tyre të mëtutjeshme. Një strategji dhe mekanizma adekuat duhet të prezantohen për të mundësuar mbledhjen e të arkëtueshmeve historike, përfshirë edhe veprimet ligjore. Njëkohësisht, duhet të vendosen kontrole efektive për të siguruar që të gjitha borxhet e debitorëve përfshihen saktë në vlerat e këtyre llogarive.			Nuk janë marrë masa.
Komponenta e auditimit	Rekomandimet e dhëna në vitin 2016	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
1.2 Pajtueshmëria me kërkesat për Pasqyrave Financiare Vjetore	Kryetari duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Theksim të Çështjes së Opinionit. Duhet të ndërmerren veprime për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike për t'i evituar gabimet në paraqitjen jo të plotë të pasurive jo financiare, bartjen e të hyrave vetjake, si dhe keq klasifikimet e ndodhura. Gjithashtu, duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2017 i adreson të gjitha çështjet e ngritura në raport dhe Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të dorëzohet, përveç nëse ndaj draft PFV-të janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.		Komuna ka përmirësuar mënyrën e raportimit për bartjen e të hyrave dhe klasifikimin e shpenzimeve, mirëpo edhe me tutje duhet të përmirësoje mënyrën e menaxhimit, evidentimit dhe raportimit të pasurisë.	
2.1 Zbatimi i rekomandimeve nga viti paraprak	Kryetari duhet të siguroj se plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve ende të pa zbatuara specifikon qartë masat dhe veprimet e nevojshme për të korrigjuar dobësitë dhe mangësitë e identifikuara. Përparësi në trajtimin e rekomandimeve duhet të kenë çështjet që konsiderohen më të rëndësishme dhe që përmbajnë nivel më të lartë rreziku. Aplikimi i masave të përgjegjësive ndaj personave të ngarkuar me zbatimin e rekomandimeve duhet të zbatohen.		Komuna e kanë përgatit planin për zbatimin e rekomandimeve, mirëpo niveli i zbatimit të rekomandimeve është shumë i ulët.	

2.2 Pyetësi i vet-vlerësimit	Kryetari duhet të sigurojë se janë hartuar strategjia për zhvillim dhe regjistri i rreziqeve. Pasi të jenë hartuar këto dokumente, të sigurojë se është deleguar përgjegjësia e drejtpërdrejtë tek persona kyç për menaxhimin dhe monitorimin e tyre, dhe të kërkojë raporte në baza të rregullta për zbatimin e tyre.		Pyetësi i vet-vlerësimit është bërë, mirëpo nuk është hartuar regjistri i rreziqeve.	
2.3.1 Përcaktimi i objektivave strategjike	Kryetari duhet të miratojë një plan të përgjithshëm strategjik për komunën i cili do të përcaktojë objektivat afatgjata dhe të shërbejë si platformë orientuese për hartimin e planeve vjetore, kryerjen e analizave krahasuese mes viteve dhe matjen e rezultateve kundrejt objektivave. Gjithashtu, komuna duhet të hartoj edhe planet tjera të përmendura më lart.		Komuna kanë hartuar planin strategjik, mirëpo edhe me tutje duhet të përgatisin planet tjera operative.	
2.3.2 Raportimi menaxherial dhe llogaridhënia	Kryetari duhet të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë dhe të siguroj se është vendosur një zgjidhje e përshtatshme gjatë muajve në vijim.			Nuk janë marrë masa.
2.4 Sistemi i auditimit të brendshëm	Kryetari duhet të siguroj se rekomandimet e dhëna nga NJAB duhet të zbatohen nga të gjitha njësitë administrative të komunës të cilave iu atribuohen rekomandimet dhe të ushtroj monitorim sistematik të procesit. NJAB në planin e aprovuar vjetor duhet të fokusohet në fushat që përmbajnë nivel të lartë të rrezikut. Po ashtu, çështja e themelimit të Komitetit të auditimit duhet të merret në shqyrtim.			Nuk janë marrë masa.
3.1 Realizimi i buxhetit	Kryetari duhet të ndër marrë një vlerësim sistematik të arsyeve për trendin renës të investimeve kapitale, nivelin e ulët të ekzekutimit të buxhetit për investimet kapitalet si dhe të sigurojë se planifikimi për kategorinë e pagave dhe mëditjeve të jetë i bazuar në nevoja reale.	Po		


3.1.1 Të hyrat	Kryetari duhet të siguroj që planifikimi i të hyrave të jetë i bazuar në të dhëna dhe pritshmërinë reale për realizim, dhe të siguroj se verifikimi i pronave ekzistuese të bëhet sipas Ligjit të Tatimit në Pronë.	Po		
3.1.2 Paga dhe Meditje	Kryetari duhet të sigurojë se kontrollet janë shqyrtuar, dizajnuar dhe vendosur në të gjitha nivelet drejtuese lidhur me fushat e pagave, dhe të sigurojë që dosjet e personelit duhet të plotësohen me të gjitha kërkesat kryesore që kërkohen me rregullore, si dhe vlerësimi vjetor i performancës të bëhet në fund të vitit.	Po		
3.1.3 Mallra dhe shërbime	Kryetari duhet të shqyrtojë arsyet e dështimit të kontrolleve në rastet kur bëhen pagesat për pranimin e mallrave, pagesat me rastin e bashkëfinancimeve dhe në rastet e pagesave pa procedura, duke shtuar kontrollet për të parandaluar përsëritjen e rasteve të tilla.		Në raport me vitin e kaluar janë përmirësuar kontrollet në rastin e pagesave, megjithëse edhe këtë vit kemi hasur në disa parregullsi të cilat janë raportuar.	
3.1.4 Subvencionet	Kryetari duhet t'i rishikojë kontrollet mbi ndarjen e subvencioneve për të siguruar zbatim të plotë të rregullores së brendshme dhe monitorim efektiv të shfrytëzimit të mjeteve të ndara nga buxheti i komunës për të siguruar arritjen e objektivave të synuara.	Po		
3.1.5 Investimet kapitale	Kryetari i Komunës duhet të ndërmerri masat e duhura në forcimin e kontrolleve për të siguruar shpenzimin e buxhetit në baza të rregullta, të caktojë anëtarët e komisionit sipas marrëveshjeve dhe të sigurojë se regjistrimet bëhen në kodet adekuate për të parandaluar mbivlerësimin e pasurisë kapitale.	Po		

3.2.1 Pasuritë kapitale dhe jo kapitale - Prioritet i lartë	Kryetari duhet të sigurojë që komisioni për inventarizim dhe vlerësim të pasurive duhet të krijohet çdo vit në kohë adekuate që të kryhet inventarizimi i tërësishëm për të konfirmuar ekzistencën e pasurive (në veçanti të pasurive të luajtshme). Të gjitha aktivitetet duhet të autorizohen nga ana e Kryetarit dhe të kryhen para se PVF-të e vitit 2017 të jenë dorëzuar në MF.			Nuk janë marrë masa.
3.2.2 Të arketueshmet	Kryetari duhet të monitorojë në mënyrë sistematike çështjen e realizimit të të hyrave, për të siguruar se janë vendosur mekanizma efektiv për reduktimin e këtyre borxheve si dhe të propozohen veprimet konkrete për mbledhjen e këtyre borxheve, duke përfshirë ushtrimin e masave administrative (nëse ka nevojë).			Nuk janë marrë masa.

Shtojca III: Letër konfirmimi



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo – Municipality of Novo Brdo



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2017 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare të Komunës së Novobërdës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017 (në tekstin e mëtejme "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

z. Svetislav Ivanovic

Kryetar i Komunës së Novobërdës,

Data: 28.Maj.2018, Novobërdë,